



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:001140
Datë: 03.06.2024
Numri i dokumentit: 05771213

C.nr.79/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Argjent Berisha nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fadil Sinanaj, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimi në pagë, me vlerë të kontestit 2,235.66 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 23.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

P Ë R S H K A K T Ë P A D Ë G J U E S H M Ë R I S Ë / M O S B I N D J E S

I. APPROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit Argjent Berisha nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, që në emër të shpërblimit të pagave të rregullta mujore në fund të viteve 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj paditësit shumën prej 2,235.66 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 18.12.2023, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën defititive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 18.12.2023, ka paraqitur padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimi në pagë, me vlerë të kontestit 2,235.66 euro.

Në padi, paditësi ka theksuar se ka themeluar marrëdhënie pune te e paditura, e sistemuar në vendin e punës Zyrtare Policore në Drejtorinë Rajonale në Gjilan, ndërsa bazuar në nenin 29 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës të datës 14.11.2018, të njëjtit i takojnë shpenzimet në pagë për kohën e kaluar gjatë viteve 2019-2021,

ndërsa për pagë të rregullt mujore si në fund të çdo viti kalendarik, për vitet 2019, 2020 dhe 2021 i takon shuma prej 2,235.66 euro. Për realizimin e këtyre të drejtave, ka theksuar se i është drejtuar të paditurës me kërkesë, mirëpo është refuzuar nën arsyetimin e mungesës së mjeteve financiare.

Gjykatës i ka propozuar që të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën në emër të kompensimit për shujtë ditore për vitet 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj paditësit shumën prej 2,235.66 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën defititive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në mënyrë të specifikuar: 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 30.00 euro, për taksë gjyqësore.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë, më datë 06.02.2024 ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi, të cilën i padituri, së bashku me shkresat e lëndës e ka pranuar më datë 12.02.2024, sipas fletëkthesës që gjendet në shkresat e lëndës. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes. I padituri, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ke gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Gjykata nga provat në shkresat e lëndës ka vërtetuar faktin se paditësi është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data 07.07.2003 (vërtetimi nr.ref.07/1-01SAP-P/3885, dt. 29.04.2021), për periudhën 2019 dhe 2021 është vlerësuar me vlerësimin plotësisht i kënaqshëm dhe për vitin 2020 me vlerësim që i tejkalon kërkesat (formulari i vlerësimit të performancave për këto 3 vite) dhe është paguar në shumën prej 795.50 euro në muajin dhjetor të vitit 2019; 823.42 euro në muajin dhjetor të vitit 2020; dhe 616.74 euro në muajin dhjetor të vitit 2021 (lista e pagës e lëshuar në emër të paditësit nga BRK).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata gjeti se themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuar i ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e

Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenin 44, paragrafi 2 të Ligjit për Policinë që përcakton se “Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”; nenin 55, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 se “Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”, e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (dt.14.11.2018), që në nenin 5, paragrafi 2 përcakton se “Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”; pika 2 e këtij se “Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative”; si dhe nenin 29, paragrafi 2 se “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.

Zbatimi i këtyre dispozitave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.213/2023 të dt.09.10.2023.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj që të ia paguaj pagën e 13-të për çdo fundvit, pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht, vlerësimi i performancës për vitin 2019, 2020 dhe 2021, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 150 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.79/24, më datë 23.05.2024

Gjyqtari,
Berat Spahiu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.